



Datë: 23.07.2025
Numër Protokolli: 5065/2025

A.nr.966/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.966/2025 të datës 26.05.2025 të parashtruar nga ankuesja L.R, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Faton Fetahu, nga Prishtina, kundër Vendimit të datës 07.05.2025 të Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Ndërprerje e Marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht** si e bazuar ankesa A.nr.966/2025, e datës 26.05.2025 e parashtruar nga ankuesja L.R, ashtu që aprovohet pretendimi ankimor i ankueses se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk është zbatuar drejtë parimi i proporcionalitetit dhe prarimi i individualizimit të masës disiplinore.
- II. Refuzohet** pretendimi ankimor i ankueses si në ankesën e saj të datës 26.05.2025 se e njëjta nuk ka kryer shkelje të rënda disiplinore.
- III. Ndryshohet** Vendimi I-411/02-KOM, i datës 07.05.2025 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë, ashtu që masa e shqiptuar disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, ndryshohet me masën disiplinore “*pezullimi nga pozita pa pagesë për gjashtë (6) muaj*”.
- IV. Obligohet** Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi, ashtu që ankuesen duhet të kthejnë në vendin e saj të punës duke filluar nga data 14.08.2025, sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 11.04.2019
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, L.R (*tani e tutje referuar vetëm: Ankuesja*), më datë 26.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.966/2025 me numër protokolli:3471/2025, kundër Vendimit të datës 07.05.2025 të Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes të cilit akt, ankueses i është shqiptuar masa disiplinore “*Largim nga Shërbimi Civil*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.05.2025 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 02.06.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ndërsa Kolegji i Këshillit me datë 09.07.2025 ka kërkuara sqarime shtesë nga organi i punësimit, përgjigje të cilën Këshilli e ka pranuar me datë 09.07.2025.

Kryetari i Këshillit, me datë 27.06.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:4424/2025, përmes të cilit ankuesës së ankuesit nën shenjë A.nr.966/2025 të datës 26.05.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën e datës 26.05.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 07.05.2025 të Komisionit Disiplinor; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 30.06.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 02.06.2025; Akt Emërimit e datës 26.02.2024; Ndryshimin dhe plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 20.02.2020; Vendimin e datës 06.12.2024 të UD. Sekretares së Përgjithshme të MINT; Akt Emërimit e datës 26.02.2024 me shifër AE.NR.35/2024; Vendimin e datës 10.04.2025 të UD. Sekretares së Përgjithshme të MINT; Vendimin e datës 21.02.2025 të UD. Sekretares së Përgjithshme të MINT; Korrespondencë e datës 04.02.2025 dërguara nga V.R-V për ankuesen; Korrespondencë e datës 04.02.2025 dërguara nga V.R-V për E.K; Korrespondencë e datës 09.01.2025 dërguara nga V.R-V për E.K; Korrespondencë e datës 04.02.2025 dërguara nga V.R-V për ankuesen B.B; Korrespondencë e datës 09.01.2025 dërguara nga V.R-V për B.M; Korrespondencë e datës 10.02.2025 dërguara nga V.R-V për ankuesen; Procesverbali i datës 07.02.2025 për dëshmitaren B.B; Procesverbali i datës 07.02.2025 për iniciuesen e procedurës E.K; Procesverbali i datës 11.02.2025 për ankuesen; Procesverbali i datës 14.01.2025 për dëshmitaren B.B; Formular i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 31.01.2022; Formular i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 26.01.2023; Vendimin e datës 30.04.2025 të UD. Sekretares së Përgjithshme të MINT; Ankesën e datës 18.02.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 03.01.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Vendimin e datës 13.02.2025 të Komisionit Disiplinor; Plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 10.01.2025; Ankesë e datës 11.11.2024; E-mailin e datës 08.01.2024 dërguar nga I.K për E.K me korrespondencën e bashkëngjitur; Vendimin e datës 18.11.2024 të UD/Kryeinspektore në Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut; Vendimin e datës 28.10.2024 të Inspektorit të Tregut me aktvendimin e datës 28.10.2024; Pëlqimin e datës 01.11.2024; Kërkesën e datës 20.09.2024; Çertifikatë e regjistrimit e datës 18.07.2024; Procesverbal i datës 23.10.2024; Procesverbal i datës 04.10.2024; Kërkesë e datës 30.09.2024; Përgjigje e datës 10.09.2024; Vendimin e datës 14.01.2025 të Komisionit Disiplinor; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 03.12.2024; Ankesën e datës 18.11.2024 me shifër:5934/19; E-mailin e datës 02.12.2024 dërguar nga ankuesja për E.K; Formular i regjistrimit të ankuesës i datës 21.02.2025;

Kërkesë për përgjigje e datës 03.03.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 05.03.2025; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit të ankueses i datës 11.04.2019; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022; E-mail i datës 09.01.2025 dërguar nga V.R-V për B.F.M dhe të tjerët; Vendimin e datës 12.11.2024 të U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Vendimin e datës 16.01.2025 të U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Vendimin e datës 12.12.2024 të U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Vendimin e datës 09.12.2024 të U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Akt Emërimit të datës 26.02.2024; Akt Emërimit të datës 31.01.2012; Vendimin e datës 23.05.2024 të U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 07.10.2014; Vendimi i datës 23.01.2025 i UD. Sekretares së Përgjithshme të MINT; Vendimin e datës 16.01.2025 të Komisionit disiplinor; kërkesë e datës 09.07.2025; përgjigje e datës 09.07.2025.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtruara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses e datës 26.05.2025 është **pjesërisht e bazuar**, sepse: Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesja sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 11.04.2019 është e punësuar në pozitën *Zyrtar Ligjor* në Inspektoratin e Tregut në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa ndaj të njëjtës Ushtruesja e Detyrës së Kryeinspektores në Inspektoratin e Tregut, më datë 03.12.2024 përmes shkresës me shifër:1-1323/19 i është drejtuar Komisionit Disiplinor me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me supozimin se ankuesja ka kryer shkelje të rënda të përcaktuara me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, 4.9, 4.13 dhe 4.14 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe me nenin 5, paragrafi 6, 8 dhe 9, nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.9 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Po ashtu, Ushtruesja e Detyrës së Kryeinspektores në Inspektoratin e Tregut me datë 10.01.2025 ka bërë plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, me supozimin se përveç shkeljeve nga neni 56 paragrafi 4 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, të specifikuara edhe në kërkesën për iniciimin të datës 03.12.2024, ankuesja me veprimet e saj ka rënë ndesh edhe me nenin 5, paragrafi 6, 8 dhe 9, nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.9 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Kolegji i Këshillit kishte konstatuar, se fillimisht Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, duke vepruar sipas kërkesës së datës 03.12.2024 për iniciimin e procedurës disiplinore si dhe shkresës së datës 10.01.2025 për plotësimin e kërkesës fillestare, ka zhvilluar procedurën disiplinore dhe me datë 14.01.2024 ka nxjerrë Vendimin me shifër:1-27/02-KOM përmes të cilit akt, ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore **“Pezullim nga pozita pa pagesë gjashtë muaj”** për shkak të shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, 4.9, 4.13 dhe 4.14 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe me nenin 5, paragrafi 6, 8 dhe 9, nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.9 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, me arsyetimin se ankuesja e kishte hartuar ankesën në emër të operatorit ekonomik, fakt ky i dëshmuar në e-mail e datës 02.12.2024 të cilin e kishte përcjellë tek U.D Kryeinspektorja në Inspektoratin e Tregut.

Mirëpo, pas nxjerrjes së Vendimit të datës 14.01.2025 nga ana Komisionit Disiplinor, përmes të cilit akt ankueses i ishte shqiptuar masa disiplinore **“Pezullim nga pozita pa pagesë gjashtë muaj”**, menjëherë pas këtij akti, U.D/Sekretarja e Përgjithshme në MINT, me datë 16.01.2025 përmes Vendimit me shifër Ref:02/Nr.03 e ka bërë Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit me numër protokolli: 1-1409/02 të datës 12.12.2024 për Formimin e Komisionit Disiplinor, gjegjësisht është ndryshuar përbërja e komisionit të cilët i kishin shqiptuar ankueses masën fillestare me datë 14.01.2025, ashtu që anëtari B.B është zëvendësuar nga anëtari F.L, kurse Komisioni Disiplinor sipas përbërjes së re, dhe në

po të njëjtën datë U.D/Sekretarja e Përgjithshme në MINT me 16.01.2025 nxjerrë Vendimin me shifër:1-33/02-KOM përmes të cilit akt ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes procedurës së iniciuara disiplinore, ndërsa më pastaj me datë 21.01.2025 U.D/Sekretarja e Përgjithshme në MINT përmes vendimit me shifër:1-50/02 e anulon Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 14.01.2025 përmes të cilit ankueses i ishte shqiptuar masa disiplinore **“Pezullim nga pozita pa pagesë gjashtë muaj”**, me arsyetimin se vendimi i Komisionit Disiplinor nuk ka qenë i drejtë pasi që ankuesja ka kryer vepra të kundërligjshme dhe jo të lejueshme për shërbyesit civil, duke shtuar faktin se anëtarët e Komisionit Disiplinor (L.G dhe N.Sh) dyshojnë se veprimi i tyre nuk ka qenë i drejtë pasi që nuk janë juriste me profesion, kurse U.D/Sekretarja e Përgjithshme në MINT, vendimmarrjen e saj e mbështet në dispozita e nenit 53 të LPPA-së.

Më pas, Komisioni Disiplinor, përbërja e të cilit ishte plotësuar dhe ndryshuar me datë 16.01.2025 përmes Vendimit me shifër Ref:02/Nr.03, ka vazhduar me procedurën disiplinore, ashtu që me datë 13.02.2025 ka nxjerrë Vendimin e ri me shifër:I-115/02-KOM përmes të cilit ankueses i ka shqiptuar masën e rëndë disiplinore **“Largim nga shërbimi civil”** me arsyetimin se ankuesja ka kryer shkelje të rënda të përcaktuara me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, 4.9, 4.13 dhe 4.14 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe me nenin 5, paragrafi 6, 8 dhe 9, nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.9 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Ankuesja, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 21.02.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshilli kundër Vendimit të ri me shifër:I-115/02-KOM të datës 13.02.2025 të Komisionit Disiplinor, ndërsa Këshilli me datë 15.04.2025, përmes Vendimit A.nr.350/2025 dhe numër protokolli:2499/2025 e kishte shqyrtuar lëndën e ankueses të datës 21.02.2025, ashtu që kishte vendosur të **anulohet**: Vendimi i datës 23.01.2025 i U.D/Sekretares së Përgjithshme, Vendimi i datës 14.01.2025 si dhe Vendimi i datës 13.02.2024 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa lënda ishte kthyer në **rishqyrtim** dhe **rivendosje** për shkak se Kolegji i Këshillit kishte konstatuar se procedura në fjalë, ishte përcjellë me shkelje procedurale sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: **“52. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative”** dhe shkeljeve të ligjit material që ndërlidhet me themelimin e apo përbërjen e komisionit disiplinor sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 60 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Me rastin e kthimit të lëndës së ankueses në rishqyrtim dhe rivendosje përmes vendimit A.nr.350/2025 të datës 15.04.2025, Kolegji i Këshillit e kishte udhëzuar Komisionin Disiplinor që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme procedurale sikurse përcaktohet me dispozitat ligjore të LPPA-së dhe ligjit material, respektivisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ashtu që Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit të lëndës ankueses lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore, ishte udhëzuar që duhet ta ketë parasysh faktin se duhet të marrë përbazë dispozitat e aplikuara nga ligji material, respektivisht dispozitat e nenit 55 lidhur me përgjegjësinë disiplinore dhe nenin 61 lidhur me parimin e individualizimit të masave disiplinore nga Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe në secilin rast duhet të zbatojnë drejtë dispozitat e aplikuara nga neni 13, 14 dhe 15 të Rregullores Nr.01/2024 Për Disiplinën e Nëpunësve Civil, ndërlidhur me dispozitat e aplikuara ligjore të përcaktuar si në nenin 2, paragrafi 1, në paragrafi 1.1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kurse U.D/Sekretarja e Përgjithshme e MINT, duhet ta ketë parasysh faktin që në secilin rast Komisioni Disiplinor duhet të jetë i themeluar në pajtim me dispozitat e nenit 60 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-

197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.01/2024 Për Disiplinën e Nëpunësve Civil, sikurse që anëtarë të komisionit përkatës nuk mund të jetë asnjë nëpunës civil, nëse paraprakisht nga ZKA nuk është përfshirë në atë komisioni, si dhe organi punëdhënës kur themelon një komision, apo zyrtari në rastet kur është pjesë e një komisioni me kompetencë të vendimmarrjes duhet të ketë parasysh dispozitat nga nenin 29 i LPPA-së, ndërsa plotësimi dhe ndryshimi i Komisionit Disiplinor duhet të jetë i arsyetuar me shkrim sikurse përcaktohet me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi.

UD/Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Këshillit A.nr.350/2025 të datës 15.04.2025, përmes Vendimit Nr.I-309/02 të datës 10.04.2025 e ka themeluar Komisionin Disiplinor në këtë përbërje, E.K-Kryesuese e Komisionit (*njëherit rezulton se e njëjta është edhe iniciuesja e procedurë disiplinore ndaj ankueses*), A.M- anëtar i komisionit, ku sipas aktit të emërimit të datës 26.02.2024 mban pozitën “Inspektor i Tregut”, A.B- anëtare e cila sipas Vendimit Nr.I-1341/02 të datës 06.12.2024 ushtron pozitën “Zyrtare e Lartë e Personelit”, mirëpo UD/Sekretarja e Përgjithshme përmes Vendimit të datës 30.04.2025 e ka ndryshuar dhe plotësuar Vendimin Nr.I-309/02 të datës 10.04.2025 për themelimin e Komisionin Disiplinor, ashtu që zyrtarja E.K në cilësi të Kryesueses së Komisionit e cila njëherit rezulton të jetë edhe iniciuesja e procedurës disiplinore ndaj ankueses, është zëvendësuar me zyrtarin F.L i cili sipas aktit të emërimit të datës 26.02.2025 mban pozitën “Inspektor i Tregut”.

Kolegji i Këshillit konstatoi se Komisioni Disiplinor në rishqyrtim të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 03.12.2025, përmes Vendimit Nr.I-411/02-KOM të datës 07.05.2025, ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*” me arsyetimin se ankuesja ka kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, 4.13 dhe 4.14 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërsa lidhur me kërkesën për plotësimin e iniciimit të procedurës disiplinore sipas shkresës së datës 10.01.2025, Komisioni Disiplinor ka marr qëndrim të njoftimit të iniciueses disiplinore se çështjet e ngritura përmes shkresës së datës 10.01.2025 për plotësimin e kërkesës për iniciim të procedurës, e me të cilin plotësim përfshiheshin edhe shkeljet e pretenduara se ankuesja kishte hartuara edhe dy akte-ankesa të tjera kundër organit të punësimit për L.Th.M.- L.L.C dhe B.T.P-O.Sh.p.k, janë jashtë kompetencës së Komisionit Disiplinor, duke e udhëzuar të njëjtën se për çështje të ngjashme sipas detyrës zyrtare ex-oficio mund të vazhdoni në organet përgjegjëse.

Ankuesja në ankesën e saj të parashtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar në Këshill, kundër Vendimit Nr.I-411/02-KOM të datës 07.05.2025 të Komisionit Disiplinor, pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore dhe shqiptimit të masës disiplinore ka kryer shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, zbatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të ligjit material, me arsyetimin se akti i kontestuar nuk përmban detyrimet ligjore të përcaktuara me, nenin 4, paragrafi 1, nenin 5 dhe nenin 48 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe paragrafi 2 të LPPA-së, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikim i gabuar i ligjit material nga neni 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, 4.13 dhe 4.14 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, po ashtu Komisioni Disiplinor ka dështuar të zbatoj parimin e individualizimit të përcaktuar në nenin 61 të LPPA-së, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankueses në tërësi, të anuloi aktin e kontestuar dhe të obligoi organin e punësimit që ankueses t’ia largoi masën e shqiptuara disiplinore.

Kolegji i Këshillit, fillimisht analizoi përmbajtjen e aktit të kontestuar dhe konstatoi se Komisioni Disiplinor shqiptimin e masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*” e kishin mbështetur duke iu referuar shkeljeve të rënda të përcaktuara me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, 4.13 dhe 4.14 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me arsyetimin se ankuesja ka kryer shkelje të

rënda disiplinore, për shkakun se e njëjta e kishte hartuar ankesën kundër organit të punësimit në emër të operatorit ekonomik H.S-P.-Sh.P.K, si dhe me pretendimin se e njëjta po ashtu kishte hartuar edhe dy akte-ankesa të tjera kundër organit të punësimit për L.Th.M.- L.L.C dhe B.T.P-O.Sh.p.k, mirëpo të njëjtat pretendime nuk kishin arritur t'i kontestonin.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit nga administrimi shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, konstatoi se Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të lëndës së ankueses kishte konstatuar drejtë gjendjen faktike sa i përket hartimit të ankesës nga ankuesja kundër organit të punësimit në emër të operatorit ekonomik H.S-P.-Sh.P.K, ngase drafti i dërguar i ankesës përmes e-mailit të datës 02.12.2024 nga ankuesja tek iniciuesja e procedurës disiplinore, respektivisht tek Ushtruesja e Detyrës së Kryeinspektore në Inspektoratin e Tregut, përputhet plotësisht me ankesën e parashtruar nga operatori i njëjtë ekonomik tek organi përkatës, gjegjësisht përputhet me ankesën e parashtruar e cila ka marr numër protokolli:5934/19 të datës 18.11.2025.

Mirëpo Kolegji i Këshillit thekson faktin se Komisioni Disiplinor, me rastin e pretendimit dhe dyshimit të bazuar se e njëjta po ashtu kishte hartuara edhe dy akte-ankesa të tjera kundër organit të punësimit për L.Th.M.- L.L.C dhe B.T.P-O.Sh.p.k, vetëm mbi bazën e arsytimit se përputhet fondi i shkronjave në ëord, struktura e aktit dhe baza ligjore, ngase këto nuk janë prova material mbi bazën e të cilave mund të arrihet tek konstatimi se ankuesja ka qenë përpiluese e tyre, madje komisioni disiplinor për këtë konstatim është kundërthënës me vetë qëndrimet e tij të shprehura si në arsyetimin e aktit e kontestuar, pasi që fillimisht në faqen tre (3), kryerreshti katër (4) të aktit të kontestuar, në mënyrë taksative specifikohet se, **citoj:** “Prandaj, Komisioni Disiplinor gjatë seancës dëgjimore po ashtu ka deklaruar se objekt shqyrtimi është kërkesa e datës 03.12.2024 me Nr.Prot.1-1323/19 për iniciimin e procedurës disiplinore. Ndërsa sa i përket plotësisht të kërkesës së datës 10.01.2025, 1-10/19 me provat e bashkëlidhura, Komisioni njoftoi iniciuesen e kërkesës së këto pretendime përmbajnë elemente të veprës penale dhe nuk është kompetencë e Komisionit Disiplinor, pasi ju sipas detyrës zyrtare “ex-officio” mund të vazhdoni në organet përgjegjëse”, kurse në faqen katër (4), kryerreshti i parë (1), ndër tjerash përcaktohet se, **citoj:** “... Si provë e pakontestueshme për mendimin tim, është plotësimi i kërkesës, përkatësisht prova nr.6, përkatësisht autorësia e dokumentit. Po ashtu, siç ceket në plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, ne kemi vënë re se në procedurë të shqyrtimit kemi pasur edhe dy shkresa apo akte të tjera për të cilat pretendojmë se autore është znj. L.R, pasi që nga ana formale, përkatësisht nga struktura, fonti i shkronjave si dhe baza ligjore rezultojnë se të njëjtat janë hartuar nga zyrtarja në fjalë në formën e njëjtë me ankesën për rastin për të cilin është iniciuar procedura disiplinore, pra shkresat e tjera kanë qenë për operatorët: L.Th.M.- L.L.C dhe B.T.P-O.Sh.p.k. Po ashtu ekziston edhe dyshimi i bazuar se nënshkrimi i këtyre akteve nuk është bërë nga përfaqësuesit e autorizuar të subjekteve të lartcekura por nga zyrtarja në fjalë , për çka konform kompetencave ligjore është iniciuar edhe Kallëzim Penal pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë”, nga rrjedh se terminologjia e përdorur nga vetë Komisioni Disiplinor nuk përkon me kompetencat dhe autorizimet e dhëna sipas ligjit material për komisionet përkatëse disiplinore, pasi që të njëjtat nuk mundën t'i ngarkojnë palët në procedurë administrative mbi bazën e pretendimeve apo dysHEMEVE të bazuara që nuk bien në fushën e tyre të përgjegjësisë apo autorizimeve ligjore, për aq kohë së konstatimi i gjendjes faktike nuk bëhet mbi bazën e provave materiale, gjegjësisht Komisioni Disiplinor për aq kohë sa shpallet jo kompetentë të trajtojë plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore sipas shkresës së datës 10.01.2025 e ku përfshihen çështjeje ngritura me pretendimin se ankuesja ka hartuar ankesat për operatorët L.Th.M.- L.L.C dhe B.T.P-O.Sh.p.k, me arsyetimin se çështjet e tilla bien në fushën e veprimit të ndjekjes penale sikurse është Prokuroria, dhe për të njëjtat çështje ta gjejë përgjegjëse ankuesen apo t'i paraqes si rrethana rënduese ndaj saj, gjegjësisht këto veprime bien ndesh me dispozitat e aplikuara nga neni 89 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të

konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ.”, ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 3 dhe nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se: “86.3. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t’i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre; 4.1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.”, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor për çështjen në fjalë, ka ngritur pretendime dhe dyshime mirëpo nuk ka arritur ta argumentoi apo provoi me prova materiale, sikurse kishte vepruara me rastin e çështjes së hartimit të ankesës për operatorin H.S-P-Sh.p.k.

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me pretendimet e ngritura nga pala ankuese mori për bazë parimet e individualizimit të masave disiplinore të aplikuara në dispozitat nga nenin 61 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: “ 1. Për përcaktimin e masës disiplinore mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 62 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunëses/it për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore shqiptohen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.”, ndërlidhur me nenin 55 paragrafi 1 i të njëjtit ligj, ku përcaktohet se: “55.1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim.

Thënë si më lartë, me rastin e parashtrimit të kërkesës për përgjigje në ankesë te Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Këshilli përmes shkresës së datës 30.05.2025, ndër tjerash kishte kërkuar provat, **si në vijim:** “Dëshmi nëse ankuesja ka ndonjë masë disiplinore aktive; Formularët e vlerësimeve të rezultateve e të punës për vitin, 2022, 2023 dhe 2024”, ndërsa nga shkresat e lëndës të kthyer nga organi i punësimit, gjegjësisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MINT, përmes parashtresës Nr.2094/03 të datës 02.06.2025 nga sqarimet e dhëna dhe provat e ofruara, konfirmohet fakti se ankuesja nuk ka ndonjë masë aktive disiplinore, madje nuk arrihet të arsyetohet fakti se përveçse nuk ka masë aktive, e njëjta nuk ka pasur as në të kaluarën ndonjë masë disiplinore të shqiptuar, kurse lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë, organi i punësimit ka sjellë formularët e vlerësimit të rezultateve në punë, respektivisht sipas Formular të vlerësimit të rezultateve në punë të datës 31.01.2022 ankuesja është vlerësuar me notë të përgjithshme **4.1 (shumë mirë)**, dhe po ashtu edhe sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve në punë i datës 26.01.2023 ankuesja është vlerësuar me notë të përgjithshme **4.4 (shumë mirë)**, ndërsa Kolegji i Këshillit thekson faktin se në kuptim të ligjit material për shërbimin civil, vlerësimi i rezultateve në punë me notën ndërmjet 3.5 dhe 4.5 “shumë mirë” e ka këtë kuptim: **“shumë mirë”**, vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit”

Po ashtu, Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të kësaj lëndë në procedurë administrative, ndërlidhur me nenin 2, nenin 5 dhe nenin 8 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, analizoi dhe mori për bazë dispozitat e nenit 57 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtar Publik ku përcaktohet se: “2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një

*periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil.”, dhe erdhi në përfundimin se ligji material për shkelje të rënda disiplinore ka përcaktuar shtatë (7) lloje të masave, e ku masa më e rëndë është masa disiplinore “*largimi nga shërbimi civil.*”, dhe po ashtu Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se në secilin rast kur konstatohet fakti se nëpunësit civil kanë kryer shkelje disiplinore, të njëjtit mbajnë përgjegjësi para ligjit dhe ndaj tyre është përcaktuar se mundet të shqiptohen masat e përcaktuara disiplinore, mirëpo në secilin rast organet gjegjëse duhet të veprojnë sipas autorizimeve të dhëna ligjore, nën respektimin e përpiktë të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe dispozitave ligjore të ligjit material për shërbimin civil, në rrethanat e rastit konkret Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe legjislacionit sekondar që buron prej tij, nga rrjedh se Komisionet Disiplinore në rastet e shqiptimit të masave të rënda disiplinore duhet të marrin parasysh çështjen e parimit të individualizimit të masave disiplinore të aplikuara në dispozitat nga neni 61 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ashtu që të konstatohen shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj, shkallën e fajësisë, ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, si dhe përpjekjet e mëparshme të nëpunëses/it për shmangien apo kufizimin e dëmit, e që në rrethanat e rastit konkret Kolegji i Këshillit nuk gjeti se Komisioni Disiplinor të ketë zbatuar në mënyrë kumulative përmbushjen e këtyre parakushteve ligjore me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankueses, veçmas kur arrihet deri te përfundimi që një nëpunësi civil t’i shqiptohet masa më e rëndë e aplikueshme në shërbimin civil për shkelje të rënda disiplinore sikurse është masa “*largim nga shërbimi civil*”, përderisa për të njëjtin nëpunësi civil në historikun e tij të marrëdhënies së punës nuk arrihet të argumentohet fakti se në të kaluarën e tij të ketë pasur masë/masa të shqiptuara disiplinore për shkelje disiplinore, qoftë të lehta apo të rënda dhe madje vlerësimet e tij të jenë të natyrës “*shumë mirë*”, prandaj në parim ligji material ka përcaktuar disa lloje të masave disiplinore me faktin që masa fillimisht duhet të jepej ne raport me shkeljen e kryer me qëllim të vetëdijesimit të nëpunësit civil se mos respektimi i ligjit dhe detyrimeve ligjore bartë përgjegjësi dhe pasoja ndaj tij.*

Kolegji i Këshillit në këtë çështje administrative, pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç, dhe të gjitha të marra së bashku si tërësi, si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe konstatimit të gjendjes faktike, arriti në konstatimin se ankesa e ankueses e datës 26.05.2025 është pjesërisht e bazuar, ashtu që sikurse u përcaktua në dispozitivin e këtij vendimi është aprovuar pretendimi ankimor i ankueses se masa e shqiptuara disiplinore “*largim nga shërbimi civil*” është dhënë në kundërshtim me dispozitat e aplikuara nga neni 5 i LPPA-së, lidhur me parimin e proporcionalitetit ku përcaktohet se: “*1. Një veprim administrativ, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi, duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit. 2. Një veprim administrativ është në pajtim me parimin e proporcionalitetit vetëm nëse i plotëson këto kushte: 2.1. është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj; 2.2. është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, dhe 2.3. kufizimi apo cenimi i të drejtës apo interesit juridik nuk është në shpërpjestim me realizimin e qëllimit të ndjekur*” dhe nenit 61 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik lidhur me parimin e individualizimit të masave disiplinore ashtu që masa disiplinore e shqiptuar nuk është në proporcion me shkeljen e kryer, ndërsa refuzohet pretendimi ankimor se e njëjta nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Ndërlidhur me pikat e pasqyruara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja është përgjegjëse për shkelje disiplinore sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me detyrimet e zyrtarit publik sikurse përcaktohet me nenin 29 dhe 30 të të njëjtit ligj, pasi që e njëjta sipas provave të lëndës të provuara

përmes e-mailit të datës 02.12.2024 të dërguara nga ankuesja te Ushtruesja e Detyrës së Kryeinspektore në Inspektoratin e Tregut, draft ankesa e dërguar përputhet me ankesën e parashtruar nga operatori i njëjt ekonomik tek organi përkatës, gjegjësisht përputhet me ankesën e parashtruar nga H.S-P-Sh.p.k, e cila ka marr numër protokolli:5934/19 të datës 18.11.2025, përderisa ankuesja këtë veprim nuk e ka të përcaktuar me përshkrim e detyrave të punës për pozitën që mbanë, respektivisht një veprim i tillë përbënë shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuara si në nenin 56 paragrafi 4, nën paragrafi 4.4, 4.5, 4.6, 4.7 dhe 4.13 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, mirëpo Kolegji i Këshillit sikurse e pasqyroj më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore “largim nga shërbimi” nuk ka ndjekur apo zbatuar drejtë nenin 5 të LPPA-së si dhe nenin 61 paragrafi 1 të LZP-së, prandaj Kolegji i Këshillit vendosi që ta ndryshoi masën disiplinore, ashtu që masa disiplinore “largim nga shërbimi civil”, ndryshohet në masën disiplinorë “*pezullimi nga pozita pa pagesë për gjashtë (6) muaj*” e përcaktuar si në nenin 57 paragrafi 2, nën paragrafi 2.5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, madje të njëjtën masë fillimisht ia kishte shqiptuar edhe Komisioni Disiplinor përmes Vendimit I-27/02-KOM të datës 14.01.2025.

Me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike, Kolegji i Këshillit përmes zyrtarit të autorizuar në lëndën përkatëse me datë 09.07.2025 kishte kërkuar sqarimet e nevojshme tek Njësia e Burimeve Njerëzore në MINT, për çështjen si në vijim: “*Lidhur me shqyrtimin e ankesës së ankuseses L.R, e cila aktualisht është e evidentuara nën shenjën A.nr.966/2025, kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 07.05.2025, kërkojmë sqarimet e nevojshme të përcaktuara si më poshtë: “1. Aktualisht, ankuesja L. R a është duke e vijuar punën; 2. Nëse e njëjta nuk është duke u paraqitur në punë si pasojë e veprimeve të organit të punësimit, ju lutem ta konfirmoni datën e saktë prej së cilës e njëjta nuk vijon punën; 3. Gjatë periudhës kohore respektive, a është duke pranuar kompensim në pagë;”*, kurse në përgjigjen e saj Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes e-mailit të datës 09.07.2025 e konfirmon faktin si në vijim: “*Në lidhje me pyetjet tuaja, ju informojmë si në vijim: 1. Nëpunësja L. R aktualisht nuk është duke e vijuar punën, si pasojë e dy vendimeve të Komisionit Disiplinor, me të cilat ndaj saj është shqiptuar masa disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil”; 2.Bazuar në vendimet e lartcekura, L. R nuk vijon punën që nga data 13.02.2025; Po ashtu, nga data 13.02.2025 (vendimi i Komisionit Disiplinor me masën Largim nga Shërbimi Civil) e tutje, e njëjta nuk ka pranuar asnjë kompensim në pagë.”*”.

Lidhur me konstatimin e dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit thekson faktin se organi i punësimit masat i ka ekzekutuar në kundërshtim me frymën e dispozitave nga nenin 144 i LPPA-së, mirëpo në rrethanat e rastit konkret, meqenëse ankuesja nuk ka vijuar punën si dhe nuk është kompensuar si pasojë e veprimeve të organit të punësimit, sikurse edhe është kontestuar fakti se ankuesja është përgjegjës dhe meqenëse Kolegji i Këshillit vendosi që ankuseses t’ia ndryshoi masën disiplinore në “*pezullim nga pozita pa pagesë për gjashtë (6) muaj*”, atëherë Kolegji i Këshillit konstaton faktin se periudha kohore nga data 13.02.2025 llogaritet si kohë e shqiptimit së masës disiplinore, respektivisht si dita e parë e fillimit të zbatimit të masës disiplinore “*pezullimi nga pozita pa pagesë për gjashtë (6) muaj*“, ndërsa masa disiplinore arrin përmbushjen e efektivitetit të gjashtë (6) mujorit të saj me datën 13.08.2025, nga rrjedh se organi i punësimit është i obliguar që ankuesen ta kthej në vendin e saj të punës që nga data 14.08.2025 sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 11.04.2019, mirëpo ankuesja duhet ta ketë parasysh faktin përsëritja e shkeljeve të tilla bartë përgjegjësi disiplinore, sikurse e njëjta duhet të kujdeset për zbatimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore të përcaktuara si në kapitullin e II të Ligjit Nr.06/L-197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nënin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.966/2025, datë 23/07/2025.

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, Avokatit Faton Fetahu;
- Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (Sekretares së Përgjithshme, Komisionit Disiplinor dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.